

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Nexhat Aliu me sekretaren juridike Azize Rama, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit K. B. i nga fshati B., K.Viti, kundër të paditurit D. S. (N) nga Vita, tani me adresë të panjohur, të cilin e perfqason përfaqësuesi i përkohshëm av. G. R. nga Vitia, baza e kontestit njohja e te drejtes së pronsis, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 23.08.2017, shpall këtë;

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET kërkesëpadia e paditësit K. B. nga fshati B., dhe **i njihet** e drejta e pronësisë në ngastren kadastrale nr.xxxx ne vendin e qujtur “Gxx” ne siperfaqe prej xx m2. ZK.Viti, e regjistruar në emër të paditurit Dxx Sxx (Nxxx), **në bazë të shitblerjes.**

DETYROHET i paditurit D.. S.. (N..) nga Vitia, tani me adresë të panjohur, t’ia njohë të drejtën e pronësisë paditësit K.. B.. dhe të durojë që ngastra e lartpërmendur t’i regjistrohet në emrin e paditësit.

Ky Aktgjykim për Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Viti, paraqet bazë, që në regjistrat kadastralë, të bëhet ndryshimi.

II.Shpenzimet e procedurës do t’i heq paditësi.

A r s y e t i m

Gjykata të paditurit D. S. N. ish nga Vitia, ju kishte dërguar përgjigje në padi, por përgjigjja ishte kthyer, sepse të paditurit ishte e pamundur t’i gjindet adresa e vendbanimit apo vendqëndrimit, ne fletëkethese thuhej se i paditurit ishin i panjohur.

Paditësi me anen e parashtresës të dt. xxxx ka berë terheqjen e padisë ndaj të paditurit D. T., dhe D.N.B. në kuptimin objektiv dhe subjektiv për ngastren kadastrale me nr.xxxx në vendin e quajtur piskavica gomilica në siperfaqe prej xxxx m2 ZK.Viti ashtu që tani e tutje si i paditur do të mbesin I.. I. nga Vitia si pronar faktik dhe djali i D. N. (B.) D.S. N.. si pronar juridik. Gjykata ka aprovuar propozimin e paditësit që tani e tutje si të paditurë të mbesin 1.D. S. N dhe 2.I. I. nga Vitia.

Paditësi K. B. ka mbetur në tersi pran padisë dhe kerkesë padisë dhe parashtresës së ushtruar në këtë gjykatë me dt xxxx dhe ka kerkuar që gjykata të ja njohë të drejtën e pronsisë në ngastren kadastrale nr.xxx, në vendin e quajtur “xxxa” në siperfaqe prej xxx m2 . Keto ngastra babai imë N. B. i ka blerë nga babai i të paditurit të pare I. I. në vitin xxxx dhe që nga kjo kohë ka hyer në posedim dhe shfrytzim pa u penguar nga askushë.

I padituri I. I. ka deklaruar nuk e kundërshtoj padinë e askerkesëpadin e paditësit K.B. se është e vertet se babai imë në vitin xxxx ja ka shitur babait të paditësit K..B., ngastren kadastrale, e ka paguar në tersi dhe ka hyer në posedim dhe shfrytzim pa u penguar nga askush, këtë ngaster e kemi blerë nga E. Z. nga Vitia këtë e ka blerë babai imë diku para lufte.

Në seancën përgatitore më datë xxxx paditësi K.B. nga fshati B..., ka mbetur në tersi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykates qe te paditurit D. S.N. ish nga Vita, t’i caktohet një përfaqësues i përkohshëm, ku gjykata kishte vendosur duke caktuar përfaqësuesin e përkohshëm për të paditurin av. G. R. nga Vitia.

Në seancë e dt. xxxx, paditësi kishte propozuar caktimin e një eksperti të gjeodezisë dhe s'bashku me të gjykata të del në vendin e ngjarjes për të identifikuar dhe përkufizuar ngastren kontestuese. Ai me tej ka deklaruar se mbetem ne teresi pran padijes dhe kerkes padijes dhe kerkoj qe te me njihet e drejta ne pronësis ne ngastren nr.xxxx ne vendin e qujtur " Gxxx" ne sipërfaqe prej xxx m2, ZK.Viti, te cilen ngaster e ka blere babai i paditësit diku ne vitin xxxx nga i padituri I. I.

Përfaqësuesi i përkohëshëm i të paditurve av.G.R.deklaron: fillimishte ne seancen e sotme pregaditore e kundërshtoj kerkese padin e paditesit K. B., ndaj te paditurit D. S.. (N.) lidhur me ngastren kadastrale xxxx me sipërfaqe prej xxx m2, ZK.Viti, ndersa sa i perket propozimit per caktimit te ekspertit gjeodet per identifikimin e ngastres se lartë shenuar nuk e kontestoj.

Me dt.xxxx, gjykata kishte dalur në vendin e ngjarjes së bashku me ekspertë e gjeodezisë dhe kishte bërë identifikimin- verifikimin dhe kishte konstatuar se ngastra kadastral per nga gjatesia shtrihej Veri Jugë ndera per nga gjersia lindje -perendim, e cila sipas gjendjes faktike ishte e mbjellur miser.

Në seancën kryesore të datës xxxx, paditësi kishte mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se ngastren kontestuese paditësi e ka blerë dhe e shfrytëzuar pa u penguar nga askushë dhe e kishte paguar qmimin e kontraktuar dhe kishte hy ne posedim të pa penguar nga askush. Po ashtu, paditësi K. B. kishte propozuar të dëgjohen dëshmitarët E. Z. nga Vitia dhe Z. F. nga Ferizaji që ma pare kishte jetuar në fshatin L....

Përfaqësuesi i përkohëshëm i të paditurve av. G. R., nuk e kishte kundërshtuar propozimin e paditësit për ndëgjimin e dëshmitarëve.

Paditësi K. B. deklaron pasi që kemi pranuar nga ana e Gjykatës ekspertizen e ekspertit gjeodet nuk kemi vrejte.

Përfaqësuesi i perkoshem i të paditureve D.. S. (N.) av. G. R. deklaron: Nuk ka vrejte ne ekspertizen e perpiluar nga eksperti gjeodete.

1.Dëshmitari E. Z. ka deklaruar: Kete ngaster e kam blerë dikun para xx viteve, kjo ngaster gjindet ne vendin e qujtutr "Gx" kur e kam blerë une ka qen me kultur livadh, ndersa nuk e di se qka eshte tashtë. Ngastren e kam blere prej H. I. nga fshati L., babait te Z. F.të cilet tashte jetojne ne F.. Une ketë ngaster e kam mbajtur nje kohe te gjatë se sa e kam mbajtur sakte nuk e di por gjate e kam mbajtur dhe më vonë ja kam shitur H. B. nga Vitia, mbiemri I.. Që si i paditur po e shofe se qenka edhe djali i tij I. I.. H.I.une ngastren ja kam shitur një vjete para Luftes. Une kur e kam blere kete ngaster kam qen duke jetuar ne fshatin L..e qe nga viti xxx kam bler vendë ne Viti dhe jetoj ne Viti.

2.Deshmitari Z. F.. ka deklaruar: Ne vitin xxx kam shkuar ne xxx per te jetuar ku kam jetuar me teper se xx viteve, ne vitin xxx, babai i ime I. F..kete ngastër ja ka shitur E. Z. sa me kujtohet ne vitin xxx-xxx nga se nuk jam i sigurte nga se ka kaluar nje kohe e gjatë, ngastren une e di se ku është mirpo nuk e di se si quhet vendi por ngastra eshte pasë bashqeve-lehve te nxehta qe kan qen me pare. E naj ka paguar në teresi qmimin e kontraktuar sipas marrveshjeve gojore nga se shitblerjet jan bërë gojarishte e jo me shkrim. Babai ime kete ngaster e ka nderruar me djemet nga H. F. nga B...a ku ja ka dhëne mullirin ne reke te Binqes dhe i ka marrur dy ngastra por njera prej tyre sot eshte objekte shqyrtimi.

Gjatë leximit të shkresave gjykata ka lexuar Certifikatën me nr.xxx e dt.xxxx, ne emer te Dxx Sxx NxxLexohet pergjegjeja e AKP, nr,xxx VD e dt.xxx xxx, Lexohet pergjegjeja e policies e dt.xxxx, Lexohet ekspertiza e dt.xxx, e perpiluar nga eksperti i gjeodezise F... Sh..

Paditësi K.. B... ne fjalen perfundimtare të paleve deklaron: mbetem ne teresi si ne padi dhe kerkese padi dhe kerkoj nga gjykata qe te me njihet e drejta e pronesis ne ngastren kadastrale nr.xxxx , nga

se ne daljen e gjykates ne vendin e ngjarjes sebashku me eksperte te gjeodezise si dhe ndegjimin e te paditurit I.I. dhe deshmitareve E.Z. dhe Z. F. eshte vërtetuar mjaftë se kete ngaster e kemi blere diku ne vitin xxxx, dhe kemi paguar ne teresi andaj kerkoj nga Gjykata qe te aprovoi kerkes padijen dhe te me njihet e drejtja e pronesi ne ngastren e larte permendur.

Perfaqesuesi i paditurit D. S... (N..) av.G. R... ne fjalen perfundimtare te paleve deklarone: i propozoi gjykates qe pas shqyrtimit të te gjitha provave te vendos ne baze te dispozitive ligjore.

Gjykata duke u bazuar ne nenin 8, të LPK-së, vlerësoi provat veç e veç dhe si tërësi.

- Me leximin e certifikatës së pronës, e dates xxx, me ngastren kontestuese nr.xxx në emër të pronarit juridik D. S. (N..), gjykata vërteton se padia përputhet plotësisht në subjektet si palë kontestuese.

-Eksperiza e ekspertit të gjeodezisë F.. Sh.. tregon përputhshmërinë e kërkesëpadisë në aspektin formal me gjendjen faktike në teren, si dhe gjendjen aktuale mbi shfrytëzimin e këtyre ngastrave kadastrale.

-Deklaratat e dëshmitarve E. Z. dhe Z.F. të dhëna në seancën e fundit të shqyrtimit gjyqësor, e forcojnë kërkesën e paditësit në një rënë anë dhe besimin e gjykatës për ekzistimin e punës juridike.

Gjykata ka vërtetuar se në mes të babait të paditësit K. B., dhe të paditurive kishte egzistuar raporti juridik, i cili edhe pse jo i lidhur në formën e shkruar, ai ka prodhuar efekt juridik, me faktin se paditësi ka hy në posedim në të njëjten palujtshmëri, të cilën edhe e mbanë më tej pa u penguar nga askush.

Gjykata për tërë këtë raport juridik mes palëve ndërgjyqëse u shërbye me të drejtën materiale e cila ishte në fuqi gjatë krijimit të këtyre raportëve, siç është neni 28, i LMD-së, sepse vullneti i palëve ka fuqi detyrimi dhe është mbi ligjin.

Andaj, gjykata duke u bazuar në gjitha këto prova dhe fakte të pakontestueshme, duke qenë e pavarur në vendosje miratoi kërkesëpadinë e paditësit.

Shpenzimet e procedurës do t'i bartë paditësi Kemajl Bajrami, neni 453, i LPK-së.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI

C.nr.34/2009

Më. 23.08.2017

Sek. Juridike
Azize Rama

Gj y q t a r i,
Nexhat Aliu

UDHËZIMI PËR MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.